



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr/172 prot.

Kamëz, më 19.12.2024

V E N D I M  
Nr. 123. Datë 19/12 2024  
M B I

“NJË NDRYSHIM TË VKB NR.107 DATË 17.08.2022 MBI: “MIRATIMIN E LISTËS SË SUBJEKTEVE, POSEDUES TË NDËRTIMEVE PA LEJE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT UNAZA E MADHE E TIRANËS, SHESHI SHQIPONJA, BULEVARDI I RI, SHKOZË PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE PASKUQAN, TË CILËT PËRFITOJNË SUBVENCIONIM TË QIRASË SIPAS PARASHIKIMEVE TË VKM NR. 409, DATË 15.06.2022 “PËR RREGULLAT, MËNYRAT DHE AFATET E TRAJTIMIT TË POSEDUESVE TË NDËRTIMEVE PA LEJE QË NUK LEGALIZOHEN”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 19.12.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.97 Datë 13.12.2024 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative së Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr.22/2018 “Për strehimin social”; Ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr.409. datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve pa leje që nuk legalizohen”; Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Kamëz me nr.571 prot, datë 15.07.2022 “Për ndjekien dhe trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri, Shkozë”, Vendimi i Këshillit Bashkiak Kamëz me nr.92, datë 19.07.2022 “Mbi miratimin e vlerës së subvencionimit të qirasë për familjet që preken nga projekti Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri, Shkozë, Njësia Administrative Paskuqan”; VKB nr.99, datë 27.07.2022 “Mbi miratimin e manualit të procedurave për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit “Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri, Shkozë, Njësia Administrative Paskuqan”; Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të numërit të antarëve të subjekteve përfitues të cilët kanë nënshkruar “Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Bashkinë Kamëz për Zbatimin e Projektit Unaza e Madhe e Tiranës Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri, Shkozë, Njësia Administrative Paskuqan”si më poshtë:  
Në vendimin me nr. 107 datë 17.08.2022 të ndryshohet numri i antarëve të numri rendor 36 Znj. dhe numrit rendor 57 Znj. sipas certifikatave familjare të datës së njoftimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë me nr.571 prot, datë 15.07.2022 “Për ndjekien dhe trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit Unaza e





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri, Shkozë” i ndryshuar dhe Drejtoria  
Emergjencave Civile dhe Strehimit.

3. Ky vendim, hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015,  
“Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETAR KËSHILLI  
Hysen KOLDASHI

